



578/ Prot
17.02.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 109/1 prot.

Shkodër, më/202.2025

Lënda: Mbi vendimin nr. 4, datë 29.01.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 24, pika 4, neni 35, pika 1, shkronja "d", neni 54, shkronja "dh", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë" i ndryshuar, neni 15, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat vendore", neni 20, pika 1 dhe 5, të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 5245/24 prot., datë 30.12.2024 "Njoftim", të VKB Vau Dejës nr. 84, datë 23.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", të shkresës së Këshillit të Bashkiak Vau Dejës nr. 574 prot., datë 03.02.2025 "Shkresë përcjellëse", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 4, datë 29.01.2025 "Për miratimin e shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës të miratuar me VKB nr. 84, datë 23.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBApërfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës", me shtesë plani në buxhet në programin 10430 "Kujdesi Social", me shumën 2 999 664 lekë, për projektin "Shërbimi lëvizës në familje, për fëmijët me aftësi të kufizuara në Bashkinë Vau Dejës", me fiancimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, program i Fondit Social.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 04 datë 29.01.2025

“Për miratimin e shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës të miratuar me Vkb nr.84 datë 23.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës”.”

Në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; neni 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat vendore”; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; pika 190 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar;; VKB-në Nr.84, datë 23.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkiaë Vau Dejës Shkresës Nr. 5245/24Prot, datë 30.12.2024 me lëndë “Njoftim”, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës,Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1.Miratimi i shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, për projektin “Shërbim Lëvizës në Familje, për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar në Bashkinë Vau Dejës”. Projekti financohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, programi i Fondit Social. Ky projekt do të përfshihet në programin 10430 “Kujdesi Social” dhe shuma totale për vitin 2025 është 2,999,664 (Dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, me TVSH.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar).

KRYETAR KËSHILLIT

Ervis Shimaj



SEKRETAR KËSHILLIT

Ardian Celepija

Miratuar me 18 vota

Vota Pro 18

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 03.02.2025



№ 4690 Prot
Dat: 31.12.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E POLITIKAVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE TË INTEGRUARA

Nr. 5245 / Prot
24
Lënda: Njolltim

Tiranë, më 30.12.2024

BASHKISË VAU I DEJËS ✓

SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përmbushje të detyrimeve ligjore, për të mundësuar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve të ngritura në kuadër të fondit social, ju njofton se:

Komisioni i vlerësimit të kërkesave për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, ka miratuar vijimin e mbështetjes financiare, në vitin e dytë të ofrimit të shërbimit të përkujdesit shoqëror "Shërbim Lëvizës në-Familje për Fëmijët me Allësi të Kufizuar", në kuadër të Fondit Social 2025.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të financojë kontributin e kërkuar nga Fondi Social në vitin e dytë të ofrimit të shërbimit, deri në 60% të koston të shërbimit, në masën 2,999,664 lekë për vitin 2025.

Njësia e vetëqeverisjes vendore ka detyrimin ligjor, për të raportuar çdo katër muaj, lidhur me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, financuar nga Fondi Social, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në kuadër të bashkëpunimit, kërkohet raportimi në kohë pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe të bëhet me dije Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi zbatimin e projektit, si dhe përdorimin e regjistrit elektronik.

Nga ana juaj kërkohet, që të gjitha strukturat përgjegjëse në administrimin tuaj, të kryejnë procesin e vlerësimit dhe referimit të rastit, në ofrimin e këtij shërbimi, nëpërmjet regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe raportimin e të dhënave çdo katër muaj. Mos përdorimi i Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, do të kushtëzojë vijimin e financimit në kuadër të Fondit Social, nga ana Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Gjithashtu, Bashkitë duhet të prioritetizojnë trajtimin e rasteve të identifikuar dhe referuara nga Shërbimi Social Shtetëror.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZËNDESMINISTËR

Denada STAFERI



Adresa: "Rruga e Kavajës", Tirana, Albania. www.shendetesia.gov.al



Tabela buxhetore me zërat përkatës

Bashkia Vau i Dejës- Shërbim lëvizës në familje për fëmijët AK në bashkinë Vau i Dejës	600-601		602	SHUMA
I Punonjëse sociale- paga 83,324 lekë	999,888			999,888
I Fizioterapist - paga 83,324 lekë	999,888			999,888
I Logopedist - paga 83,324 lekë	999,888			999,888
TOTALI	2,999,664	-	-	2,999,664



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

DREJTORIA E MBROJTJES PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL

PROJEKT VENDIM

Nr 01 datë 20.01.2025

“PËR MIRATIM SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË VAU DEJËS TË MIRATUAR ME VKB-NË NR.84, DATË 23.12.2024 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2025-2027, NUMRIN E PUNJONJËSVE TË BASHKIAK VAU DEJËS”

Në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; neni 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat E vetqeverisjes vendore”; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; pika 190 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; VKB-në Nr.84, datë 23.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025-2027, numrin e punjonjësve të Bashkiaë Vau Dejës”, Shkresës Nr. 5245/24Prot, datë 30.12.2024 me lëndë “Njoftim”, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës; i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të :

VENDOSI

- Miratimi i shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, për projektin “Shërbim Lëvizës në Familje, për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar në Bashkinë Vau Dejës”. Projekti financohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, programi i Fondit Social. Ky projekt do të përfshihet në programin 10430 “Kujdesi Social” dhe shuma totale për vitin 2025 është 2,999,664 (Dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, me TVSH, sipas shkresës Nr. 5245/24 Prot., datë 30.12.2024, sipas detajimit më poshtë:

2. Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025.	Totali (Lekë)	Nga kjo:			
		Paga	Operative	Transferime	Kapitale
Burime Njerezore					
Kontribut Bashkia	1,681,884	1,681,884			



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Fondi Social	2,999,664	2,999,664			
Pajisje dhe furnizime					
Kontribut Bashkia	302,400				302,400
Kontribut donatori					
Shpenzime per aktivitete					
Kontribut Bashkia	100,000		100,000		
Shpenzime per vizibilitetin					
Kontribut (Fondi Social)					
Shuma	5,083,948	4,681,548	100.000		302,400

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi:

Gjergj Babani; Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.

Miratoi:

Ridvan Luzaku : Drejtor/ Drejtorja e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social.
Ebe Ruzi : Drejtor/ Drejtorja Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar.

KRYETAR
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni



Konfirmoi Bazën Ligjore:

Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore

Ersilda Preka: Ersilda Preka/Sektor i Asistencës Ligjore,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL

RELACION

“PËR MIRATIM SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË VAU DEJËS TË MIRATUAR ME VKB-NË NR.84, DATË 23.12.2024 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2025-2027, NUMRIN E PUNJONJËSVE TË BASHKIAË VAU DEJËS”

DREJTUAR : Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 35, pika 1, shkronja “d”, nenit 54, shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; nenit 20, pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; pikës 190 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; VKB-së Nr. 84, datë 23.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, Shkresës Nr. 5245/24 Prot., datë 30.12.2024, me lëndë “Njoftim” nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Planit Social Vendor 2021-2023, miratuar me VKB-në Nr. 84, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Social Vendor të Bashkisë Vau Dejës”, Bashkia ka aplikuar me kërkesë për financim të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor me projektin “Shërbim Lëvizës në Familje për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar në Bashkinë Vau Dejës”, në thirrjen e hapur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në programin e Fondit Social 2024.

Ky projekt ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh, dhe nëpërmjet shkresës Nr. 5245/24, datë 30.12.2024, jemi njoftuar për kalimin e fondit për vitin 2025 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në vlerën totale 2,999,664 (Dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, me TVSH. Nga vlera totale e financimit për vitin 2025, e cila është 5,083,948 (Pesë milion e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) lekë, kontributi i Fondit Social nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është 2,999,664 (Dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, me TVSH. Po ashtu, kontributi i Bashkisë për vitin 2025 është 2,084,284 (Dy milion e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) lekë, me TVSH.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Me anë të këtij financimi është planifikuar të realizohet;

Burime njerëzore: Psikolog, Punonjës Social, Fizioterapist, Logoped, Shofer për ofrimin e shërbimit për 25 fëmijë me aftësi të kufizuara, në shumën 4,681,548 (katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e tetë) lekë.

Pajisje dhe furnizime (karburant) në shumën 302,400 (treqind e dy mijë e katërqind) lekë.

Shpenzime për aktivitete (Seti i mjeteve të punës për 4 profesionistë) në shumën 100,000 (njëqind mijë) lekë.

Projekti "Shërbim Lëvizës në Familje" ka pasur një nisje të suksesshme gjatë vitit të parë të zbatimit, duke ofruar shërbime në familje për familjet me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për mbështetje dhe trajtim në kushte të përshtatshme dhe të sigurta për ta. Ky projekt ofrohet nga një ekip i përbërë nga katër profesionistë të kualifikuar: logopedi, punonjësi social, fizioterapisti dhe psikologu. Secili prej këtyre profesionistëve ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve dhe familjeve që kanë marrë shërbimin.

Në vitin e parë të zbatimit, kemi arritur të implementojmë një sërë aktivitesh dhe ndërhyrjesh që kanë pasur një ndikim pozitiv në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe familjeve, duke ofruar mbështetje në fushat e zhvillimit të aftësive të komunikimit, shëndetit mendor, rehabilitimit fizik dhe ndihmës sociale. Ky sukses i projektit është reflektuar në vlerësimet pozitive të pranuar nga familjet dhe partnerët e projektit, të cilët kanë theksuar rëndësinë e shërbimeve të ofruara dhe ndikimin e drejtpërdrejtë në jetën e tyre.

Tani, në vitin e dytë të implementimit të projektit, synojmë të vazhdojmë këtë projekt me thellimin e shërbimeve që ofrohen, duke ofruar mbështetje edhe më të specializuar për nevojat e ndryshme që mund të shfaqen gjatë kohës për fëmijët. Ekipi i Njësisë Lëvizëse do të vazhdojë të punojë ngushtë me çdo familje për të siguruar që çdo fëmijë pjesë e këtij projekti të marrë shërbimin që i nevojitet për zhvillimin dhe mirëqenien e tij.

Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi:

Çuka Babani

Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.